



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti**



**Komuna e Prizrenit**  
**Opština Prizren – Prizren Belediyesi**

---

**Procesverbali nga mbajtja e konsultimit publik me qytetarë për Projekt-  
Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026**

Konsultimi publik me qytetarë është organizuar nga grupi punues për hartimin e Projekt-Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2026.

Njoftimet për qytetarë për organizimin e konsultimit publik janë bërë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### **Publikimet:**

Publikimet janë bërë me **20.05.2024** në webfaqe zyrtare të komunës, në facebook-un e komunës, si dhe në platformën e konsultimeve publike:

Në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/wp-content/uploads/sites/26/2024/05/Njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-Planit-Lokal-te-Veprimit-per-Barazine-Gjinore-2024-2026-Shq-Bosh-Tur.pdf>

Në facebook:

<https://www.facebook.com/share/p/y3waJcBaY5ZCSicN/?mibextid=oFDknk>

Në platformë:

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42390>

Njoftimi si lajm në webfaqe:

<https://kk.rks-gov.net/prizren/news/njoftim-per-organizimin-e-konsultimit-publik-per-projekt-planin-lokal-te-veprimit-per-barazine-gjinore-2024-2026/>

**Konsultimi është mbajtur në sallën e kuvendit komunal (Shtëpia e Bardh) dhe ka filluar në orën 10:15**

### **Mybexhele Zhuri, anëtare e grupit punues për hartimin e dokumentit**

Ju faleminderit për kohën që e keni gjetë për me ardh në debatin ose konsultimin publik mbi draft planit lokal të veprimit për barazi gjinore. Ky plan ka qenë i postuar prej datës 20 maj deri 7 qershor. Do të jetë në konsultim publik dhe presim, sugjerime apo komente për me mujt me e plotësu këtë draft plan dhe pastaj shkon në miratim. Sot kam prit që do të ketë më shumë njerëz sepse barazia gjithmonë ka qenë një çështje për të cilën është debatuar shumë. Duhet kemi pak përfaqësues.

Unë do t'ju prezantoj 1 prezantim. Shkurt të them, por ndoshta pak edhe zgjat për shkak se plani është voluminoz dhe po du me dhanë 1 njoftim apo 1 përmbledhje të draft planit. Çfarë është ky dokument që prezantoi sot?

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore (PLVBGJ) 2024 – 2026 po përgatitet nga Komuna Prizren, si mjeti kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, të reflektuara në: Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Instrumentet kryesore ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit.

Ligjin për Barazi Gjinore Nr. 05/L-020, si dhe tërësinë e ligjeve të vendit të fokusuara tek barazia, mosdiskriminimi dhe fuqizimi i grave.

Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale.

Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020 – 2024, si dhe tërësinë e kornizës zhvillimore vendore (programe e strategji) për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave.

Instrumente dhe mjete të BE-së të fokusuara tek barazia gjinore, si pjesë e procesit të integritit, veçanërisht ato që përmbajnë veprimet që duhet të ndërmerren në nivelin lokal – siç është edhe Karta Evropiane për Barazi të Grave dhe Burrave në Jetën Lokale, etj.

Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, është:

një mjet praktik i lokalizimit të dokumenteve të rëndësishëm kombëtarë, por edhe ndërkombëtarë në lidhje me barazinë gjinore (veçanërisht instrumentet drejtpërsëdrejti të aplikueshme në legjislacionin e vendit).

një dokument i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, me hapa të mire përcaktuar, e në përmbajtje të cililit reflektohen arritjet dhe sfidat e ndeshura ndër vite nga Komuna, në përparimin drejt barazisë gjinore.

një pasqyrim i qartë i roleve dhe përgjegjësi të domosdoshme për t'u përmbushur brenda Komunës, si dhe ndërmjet Komunës e institucioneve lokale apo organizatave të shoqërisë civile e ato ndërkombëtare, me qëllim zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjitha/gjithë gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre, në Komunën Prizren.

Barazia gjinore nënkupton që të gjitha qeniet njerëzore, si gratë dhe burrat, janë të lirë të zhvillojnë aftësitë e tyre personale dhe të bëjnë zgjedhje pa pasur kufizime të vëna nga stereotipat gjinore, rolet e ngurta gjinore, apo paragjykimet.

Barazi gjinore do të thotë që sjelljet, aspiratat dhe nevojat e ndryshme të grave dhe burrave merren parasysh, vlerësohen dhe favorizohen në mënyrë të barabartë. Barazi gjinore nuk do të thotë që gratë dhe burrat duhet të bëhen të njëjtë, por që të drejtat, përgjegjësitë dhe mundësitë e tyre nuk do të varen nga fakti nëse kanë lindur femra apo meshkuj.

Drejhtësia gjinore nënkupton që gratë dhe burrat trajtohen në mënyrë të drejtë, sipas nevojave të tyre përkatëse. Kjo mund të përfshijë trajtim të barabartë, ose trajtim që është i ndryshëm, por që konsiderohet i barasvlerëshëm për sa i përket të drejtave, përfitimeve, detyrimeve dhe mundësive. Në kontekstin e zhvillimit, synimet për drejtësi gjinore shpesh kërkojnë përfshirjen e masave që kompensojnë për disavantazhet historike dhe sociale të grave.

Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale janë sfera të qeverisjes që gjenden më pranë njerëzve, ndaj dhe përfaqësojnë nivelet që kanë më tepër mundësi të luftojnë vazhdimësinë dhe riprodhimin e pabarazive, si dhe të avancojnë për një shoqëri me të vërtetë të barabartë.

Zbatimi dhe promovimi i të drejtës së barazisë duhet të qëndrojë në zemër të konceptit të vetëqeverisjes lokale.

Pavarësisht përpjekjeve të bëra apo që po vazhdojnë të bëhen ndër vite në këtë drejtim, si dhe plotësimin e harmonizimit të kornizës ligjore dhe të politikave lokale me ato kombëtare e ndërkombëtare, duhet të pranojmë që realiteti ende flet për barazi dhe drejtësi gjinore të munguara në praktikë.

Nëse duam të krijojmë një shoqëri të mbështetur në barazi, është thelbësore që organet e vetëqeverisjes lokale të marrin parasysh plotësisht integrimin gjinor në politikën, organizimin dhe praktikën e tyre të punës. Barazia e vërtetë ndërmjet grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve, është çelësi për suksesin ekonomik dhe shoqëror.

Komuna e Prizrenit ka ndjekur një metodologji gjithëpërfshirëse, përmes këtyre hapave: Ngritja e Grupit Punues për përgatitjen e këtij plani, me urdhër të Kryetarit të Komunës.

Analiza dhe vlerësimi i situatës përmes të dhënave dhe informacionit ekzistues.

Përcaktimi i fushave kryesore të ndërhyrjes, të domosdoshme për t'u përfshirë në matricën e PLVBGJ 2024-2026.

Konsultimet paraprake brenda komunës dhe hartimi i draft matricës së PLVBGJ.

Postimi në faqen e Komunës për komente dhe sugjerime nga individët dhe grupet e interesit.

Mbajtja e konsultimit publik me banoret dhe banorët e Komunës (takimi i sotëm)

Një rol të rëndësishëm po luan mbështetja nga UN Women Kosovë, përmes projektit “Gender Equality Facility” që financohet nga fonde të Bashkimit Evropian.

Masat dhe veprimet e parashikuara në PLVBGJ synojnë zbatimin e pesë objektivave strategjike, të cilët ndahen më pas në tetë objektivë specifikë:

Promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre.

Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim cilësor, kulturë e sport, për gratë, burrat, të rejtat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre.

Liri nga të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

Për përmbushjen e objektivave specifike dhe përparimin drejt objektivave strategjike janë parashikuar rreth gjashtëdhjetë e pesë aktivitete, të cilat shtrihen në një periudhë kohore tre vjeçare.

Në PLVBGJ gjithashtu janë përcaktuar tregues në nivel të aktiviteteve, tregues në nivel të objektivave specifike, si dhe rezultate të pritshme në nivel të objektivave specifike dhe në nivel të objektivave strategjike.

Është bërë një ndarje e qartë e institucioneve përgjegjëse dhe atyre partnere e bashkëpunëtoresh në zbatim, si dhe është përcaktuar edhe burimi i financimit, me qëllim që, për aktivitete të cilat ende nuk kanë një burim financiar të siguar, të mund të llobohet me donatorët dhe partnerët e bashkëpunëtorët për të mundësuar gjetjen e fondeve dhe zbatimin e këtyre aktiviteteve dhe PLVBGJ në tërësi.

Janë propozuar edhe takime koordinuese me OJQ e donatorë, për të mundësuar zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave specifike të këtij plani.

Monitorimi i zbatimit të PLVBGJ është përcaktuar gjithashtu qartësisht, i ndarë nga raportimi i rregullt e periodik.

Për përmbushjen e objektivave specifike dhe përparimin drejt objektivave strategjike janë parashikuar rreth gjashtëdhjetë e pesë aktivitete, të cilat shtrihen në një periudhë kohore tre vjeçare.

Në PLVBGJ gjithashtu janë përcaktuar tregues në nivel të aktiviteteve, tregues në nivel të objektivave specifike, si dhe rezultate të pritshme në nivel të objektivave specifike dhe në nivel të objektivave strategjike.

Është bërë një ndarje e qartë e institucioneve përgjegjëse dhe atyre partnere e bashkëpunëtoresh në zbatim, si dhe është përcaktuar edhe burimi i financimit, me qëllim që, për aktivitete të cilat ende nuk kanë një burim financiar të siguruar, të mund të llobohet me donatorët dhe partnerët e bashkëpunëtorët për të mundësuar gjetjen e fondeve dhe zbatimin e këtyre aktiviteteve dhe PLVBGJ në tërësi.

Janë propozuar edhe takime koordinuese me OJQ e donatorë, për të mundësuar zbatimin e aktiviteteve dhe arritjen e objektivave specifike të këtij plani.

Monitorimi i zbatimit të PLVBGJ është përcaktuar gjithashtu qartësisht, i ndarë nga raportimi i rregullt e periodik.

Me përfundimin e dëgjimit publik sot:

Do të përmirësohet draft matrica e PLVBGJ bazuar në të gjithë komentet dhe sugjerimet tuaja.

Do të përfundohet kostimi i matricës së PLVBGJ.

Do të përmirësohet përshkrimi narrativ i planit bazuar në të gjithë komentet dhe sugjerimet tuaja.

Do të ndiqen të gjithë hapat e detyrueshëm, sipas legjisllacionit në fuqi për të kaluar këtë dokument për miratim në Kuvendin Komunal.

Pas miratimit nga Kuvendi Komunal dhe dhënies së miratimit edhe nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, do të fillojë puna për zbatimin e tij.

Komuna do të mbajë vazhdimisht të informuar banoret dhe banorët mbi arritjet në lidhje me zbatimin e këtij PLVBGJ, dhe do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet lokale, organizatat e shoqërisë civile dhe ato ndërkombëtare, sipas nevojës e masave të parashikuara për përparimin drejt barazisë gjinore.

## **Tringa Kasemi**

Faleminderit shume zonja Mybexhel për përshkrimin e planit. Unë nuk kam koment, pasi kemi qenë pjesë bashkë e hartimit të planit dhe 2 punëtorive. Kam 1 vërejtje shumë serioze për drejtorët sot që as edhe një nuk qenka këtu e dimë na edhe gjithë pjesëmarrësit që e kanë marrë dokumentin

më herët që kanë goxha përgjegjësi edhe ndarje të buxhetit drejtoritë veçmas për secilën kategori të aktiviteteve tona.

Po kjo tregon, kemi nevojë me diskutue shumë, tregon për prioritizimin e barazisë gjinore nga ana e drejtorëve është vërejtje shumë e madhe.

## **Mybexhele Zhuri**

Bashkëngjitëm edhe unë këtë vërejtjen tënde, mirëpo sot shumica kanë pasur edhe takime tjera. Shpresoj se në ditën e Miratimit në kuvend, ma herët do ta kenë plane dhe dashtë zoti që ate dite do të jenë këtu, sepse ju e dini unë e sa herë edhe në asamble dhe në takime të tjera jam tu thanë se planin dhe barazi nuk e bën 1 njeri 1 zyre, po e bëjmë të gjithë dhe ky plan i ka nda përgjegjësitë për të gjithë, si për obligimet që duhet të kryhen më vonë, por edhe për buxhetin, i cili do të përdoret, nuk do të jetë zyra ajo që do ta realizojë këtë plan.

Së bashku me të gjithë edhe juve që jeni, mendoj organizatat joqeveritare dhe gjithë thjesht që dëshirojnë ta përmirësojnë gjendjen e barazisë në komunën e prizrenit. Ju faleminderit. Kush tjetër.

E para është shumë inkurajuese dhe mese mënyrë e mirë përderisa kemi ardh me diskutu për këtë plan, i përgëzohet për punën e të gjithë veç kanë qenë akterë në hartimin draftimin e këtij planit. Mirëpo nga ana tjetër jam shqetësuar në prezencën E përfaqësues Nga komuniteti të burrave dhe djemve për arsye se ashtu si edhe parafolësit e tha edhe përfaqësuesit e komunës pi shoh qe jeni veq gra.

Nuk arrihet barazia gjinore, në qoftë se ne jena tue fuqizu veç 1 komunitet. Ne e kuptojmë që kemi problemin dhe shkeljet dhe diskriminimi më i madh ka qenë prezent në komunitetin e grave dhe vajzave, mirëpo jo domosdoshmërisht duhet të mendojmë në këtë mënyrë. Në qoftë se ne nuk kemi me qenë prezent të 2 gjinitë, atë skenë emri me pas Barazi gjinore, për këtë arsye jam shumë skeptike në anën tjetër që ky dokument ndoshta do të jetë njëri nga dokumentet që do mbetet prapë në arkiv të komunës dhe do mbetet veç në letër.

Zbatimi i tij është mjaft problematik në mendësinë ku jemi për momentin. Me këtë fakt që kemi shumë pak përfaqësues edhe nga ana e qytetarëve. Atëherë është shumë e vështirë nëse ne e konceptojmë edhe të promovohet që barazia gjinore i përket vetëm gjinisë femërore apo të them veç vajzave dhe grave. Këtë pjesë duhet komuna me lobu mjaft Edhe ashtu siç cekët që prej nje zyre nuk bëhet barazia gjinore, mirëpo secila nga ne dhe secili nga ne do më pas përgjegjësi që me arrit këtë plan t veprimet.

Ta bindim veten si zyrtar që jam publik të jemi konkretë dhe të kërkojmë nga vetja për këtë zbatim të këtij plani. Në anën tjetër, sa i përket komenteve, plan ishte mjaft përfshirës, mirëpo ndjesinë ma la që prapë është 1 ndarësi dhe fuqizohet pjesa e komunitetit vetëm të grave apo vajzave duhet të jemi mjaftë këtë aspekt objektiv dhe të llobojmë gjithëpërfshirja të jetë nga të gjithë komunitetet.

Mos vazhdojmë të përsërisim gabimet, sepse nuk jemi idhtarë të asaj që të fuqizohen vetëm vajzat dhe gratë. Do të fuqizohemi bashkarisht. Faleminderit.

## **Mybexhele Zhuri**

Në planin e veprimit ndoshta keni nese e keni lexuar vizionin. Ky i adresohet kështu 1 qeverisje të mirë. Vizioni i planit me than asht i të gjithë të drejtave gjinore, ku gratë dhe burrat të rejtat dhe rinjtë, vajzat dhe djemtë prizrenit, pavarësisht moshës, vendbanimit, grupit etnik, social, aftësive të kufizuara, nevojave të veçanta, orientimit seksual e shprehjes së identitetit gjinor Statusit civil të emigrantës migrantit azilkërkues azilkërkuesit ,statusit të personit domethanë mbrojtje ndërkombëtare me status refugjatë, refugjati të përkohshëm dhe në mbrojtje plotësuese, statusi pa shtetësi, statusit të punësimit të gjendjes ekonomike përkatësisë fetare apo karakteristikat tjera individuale gëzojnë, respektojnë dhe kontribuojnë për përparimin drejt barazisë gjinore dhe zbatimit të kësaj. Asaj në praktikë dhe në gjithë fushat e jetës.

Ky është vizioni dhe më tha, të gjithë janë të përfshijnë emrin vizionit, po them pastaj gjatë aktiviteteve në çdo fushë. Përsëri ne përmendim i të gjithë diversitetin qëllimisht që mos i përsërisim të gjitha këto që janë paraparë me vizion. Unë e di që do të jetë vështirë nëse ky plan nuk është i 1-ri që është këtu. Ne kemi pas ma heret 2012, 2015 dhe 2005, 2017 e kemi reviduar planin tjetër. Barazia gjinore në gjithë botën është problem aktual ende ne kur kemi fillu me hartimin kemi mendue se nuk kemi pas shumë dëshira të mëdha. Kemi shku me ndryshime të vogla.

Nëse keni vërejt, ka shumë sesione informuese, shumë trajnime dhe disa me neve. Ende jemi në fazën e vetëdijësimit. Ju thatë se sot ata të cilët kishin gjerman vendisur besoj se kishin ardhur sepse është interesi. Edhe i grave dhe i burrave vajzave e djemve po kemi, nuk është as kemi përfaqësim edhe këtu pak janë me numër. Po unë ju falënderoj që kanë marrë pjesë dhe e vlerësoj sepse të gjithë kontribuojnë edhe interesi i të gjithëve është i përbashkët.

Nëse në popullatë është gati 55 vjet, jemi burra e gra, atëherë kapaciteti i të gjithëve nëse shfrytëzohet barazia do të përmirësohet, nuk them si do bëhet, do të përmirësohet. Po, kemi shumë punë rreth ndryshimit të mentalitetit dhe stereotipeve të cilat i kemi.

Po këto nuk arrihen vetëm me dokumente, me fjalë, por me vepra. Sigurisht që ne unë thashë edhe më herët prej të gjithë neve varet se si do të shkon dhe si do të zbatohet ky plan. Po edhe si do realizohet barazia në komunën e prizrenit. Kemi punë buxhetim gjinor shumë. Qe tash momentalisht jemi tu punu, po edhe kjo punë nuk shkon aq shpejt, sepse njerëzit duan të kualifikohen për me bo 1 analizë gjinore, por me paragjykim gjinor të 1 plani apo të 1 projekti për me mujtë, pastaj me vepra.

Po ky plan na jepni 1 platformë na jep bazën ku thirremi ne kur do e bëjë ndryshime, nëse kjo do të kalojnë në asamble komunale, atëherë ata do të zotohen, do ta marrin përgjegjësinë çdo drejtori bashkë me kryetar që të zbatohet.

## **Bashkim Gashi**

Mirë është e përshëndes pra iniciativën dhe osht nifar obligimi ligjor nuk është qejfi i dikujt që e ka bo këtë Por mirë është që ne gjithpërfshirje noshta janë përfshirë edhe organizata joqeveritare dhe zyrtarët e komunës edhe kanë arrit në një projekt i draft të planit, i cili sigurisht që në rast se realizohet po tham një 60 përqind kishte me qenë sukses për 3 vjeçarin e ardhshëm një sukses në këtë lami.

Pse po them se duke pas parasysh do të thotë prej vitit 2000 shumë plane të veprimit janë lami të ndryshme, disa ndoshta as 10 për qind nuk janë realizu fatkeqësisht dhe nuk kisha dasht që mas 3 vjete ne raportet të flitet, do të thotë për 1 numër kaq të vogël në përqindje kaq të vogël të implementimit të gjithë kësaj është vështirë, është se vështirë do të thotë.

Zonja Mybexhel e din se si profesioniste zyre sa problematike është mendu mentalitetin duhet me ndrru mentalitetin po më duket që ma keq se kur ka filluar kjo punë tha, tha vitit 2000 fillimit kur kanë qenë zgjedhjet e 1-ra, çdo vit e më keq bëhet. Pse 3 drejtoresha kanë qenë gra ne vend atyre kryetari ka vendose do të thotë burra.

Sa u ku krejt që thamë që 1 numër, pse pse ata e bëjnë politikën? Ata kanë implementuar, do të thotë keq atë buxhet që ka komuna ta vjen i shtosh mor sot këtu edhe mi kry punë cilat parashihen edhe konkretisht, ndoshta në kuadër të planit. Tjetra. 40 kryetar janë zgjedh të fshatrave dhe bashkësive lokale. Do të thotë qysh janë organizuar nëpër qytet.

Prej tyre janë vetëm 2 gra. Kjo sigurisht flet shumë për krejt. Nuk ka nevojë. Jonë tjera flasin për komunën, tash jo është bir nane apo qejfin. Edhe morem krejt të aktivitetit në ushtar me i implementu, por duhet rezultat kemi. Sipas meje, ku është rezultati? Rezultati është, thotë në rregulloren, edhe ta zbatojmë ligjin se ligji thotë 50/50 është ligji për barazi gjinore.

Edhe pse ne kundërshtim osht me atë ligj. S'di pse nuk po zgjidhet ai problem do të thotë në çështjen e kandidimit që 30 përqind do të thotë është lista. Duhet është obligative për këtu. Mendoj që fillon krejt ajo. Në rast se kishte me qenë 5 për qind, do të thotë që kjo asamble me grow, vajza dhe gra natyrisht mos përsërit çdo herë.

Sigurisht ndryshe do të thotë kish me qenë edhe mentaliteti. Ndryshe kishin me qenë do të thotë edhe veprimet ndryshe kish me qenë edhe buxhetin do më. Për barazi gjinore. Tjetra. Në rast se secili kandidat për kryetar kishte me marrë obligim që 50 për qind e drejtorëve kanë me qenë gra 50 burra. Rap kishte me qenë kjo krejt ndryshe në rast se shkon.

Natyren, rrjedhjes si është tani në binarët aktual? Besoj që nuk kemi me post fort ndryshime në aktivitete. Kemi kontribu noshta profesionist. Jemi vullnetarë, do të thotë disa që tu prej burrave që marrin pjesë marrin pjesë çdo kund do të thotë secilën, por a mjafton 2 3 vetë do të thotë me asi.

Unë i shoh në aktivitete tjera që bëhen jashtë vendit komunës nuk janë veç për kuvendin e komunës së po flas për 1 mentalitet do të thotë cili është në komunën e prizrenit organizatat joqeveritare do të thotë cilat organizojnë diçka për barazi gjinore? Iso jep çka jemi njësoj do të thotë njëjti që



marrin pjesë. Kjo është pasqyra që. Gjendja ku jemi, sigurisht që krejt dëshirojmë 1 deklarativë.  
Krejt dëshiroj me ndryshu.

**Konsultimi ka përfunduar në orën 10:45.**

Procesmbajtës: